

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"CONNECT GROUP" SH.P.K.**

Sot më datë 9 Dhjetor 2021, i nënshkruari:

Z. Donald Hoxha, shtetas shqiptar, lindur më datë 05.11.1995, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr.personal J51105058F në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ka vendosur të krijojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar **Connect Group Sh.p.k.** (në vijim referuar edhe si "Shoqëria") duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi.

Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë

Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur **Connect Group Sh.p.k.**

Neni 2 – Selia

Selia e Shoqërisë është në Rr. Siri Kodra, Godina nr.198, Njësia Bashkiake nr.8. Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është me një afat të pacaktuar.

Neni 4 - Objekti

Shoqëria do të ketë të drejtën dhe autoritetin për të kryer, brenda dhe jashtë Shqipërisë, çdo lloj aktiviteti të lejuar nga ligji, duke përfshirë specifikisht: Shoqëria do të ketë të drejtën dhe autoritetin për të kryer, brenda dhe jashtë Shqipërisë, çdo lloj aktiviteti të lejuar nga legjislacioni, duke përfshirë por pa u kufizuar në fushën e tregëtisë, import-export me shumicë dhe pakicë, të mallrave industriale, bujqësore, blegtorale dhe konfeksione.

Neni 5 – Kapitali

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 (njëqind) lekë.

5.2 Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar tërësisht si më poshtë:

- a) Z. Donald Hoxha, shtetas shqiptar mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal J51105058F ka kontribuar në kapitalin e Shoqërisë një shumë të barabartë me 100 LEK e cila tashmë është paguar.

5.3 Në bazë të kontributeve të sipërcituara:

- b) Z. Donald Hoxha zotëron 1 (një) kuote, e barabartë me 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar së shoqërisë ("Ortaku i Vetëm").

Neni 6 - Transferimi i Pjesëve të Kapitalit

Pjesët e kapitalit të Shoqërisë mund të transferohen tërësisht apo pjesërisht sipas procedurave të parashikuara në Nenin 9 të Statutit.

Neni 7 – Administratorët



- 7.1 Shoqëria administrohet nga 1 Administrator ("Administratori"), i cili do të emërohet për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjeçare nga Ortaku i Vetëm. Në fund të afatit prej 5 (pesë) viteve, përveç nëse Ortaku i Vetëm ka vendosur për shkarkimin e Administratorit para skadimit të mandatit të tij, Administratori mund të riemërohet ose të shkarkohet.
- 7.2 Administratori përfaqëson Shoqërinë ndaj palëve të treta dhe ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, duke iu nënshtruar kufizimeve të parashikuara në Statutin e Shoqërisë.
- 7.3 Me këtë akt, personi i mëposhtëm emërohet Administrator i vetëm i Shoqërisë:
- Z. Donald Hoxha, shtetas shqiptar, lindur më date 05.11.1995, banues në Tirane, Rruga Kongresi i Manastirit, mbajtës i letërnjoftimit me nr.personal J51105058F.
- 7.4 Kompetencat e Administratorit do të kryhen në përputhje me Nenin 13 të Statutit të Shoqërisë.

Neni 8 - Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 8.1 Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet ortakëve në lidhje me këtë Akt Themelimi apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 8.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9 – Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 10 - Dispozita të Fundit

Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat e Statutit të Shoqërisë dhe legjislacionit për Shoqëritë Tregtare.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë
Connect Group shpk

Z. Donald Hoxha

Donald Hoxha
